

VENDIM
Nr. 131, datë 22.2.2017

PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË MALLRAVE TË ZGJEDHURA DHE METODËN E LLOGARITJES SË INDEKSIT

(ndryshuar me VKM nr. 11, datë 11.1.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës dhe të peshës specifike të grupmallrave e shërbimeve të përzgjedhura për llogaritjen e indeksit të ndryshimit mesatar vjetor të çmimeve të mallrave të konsumit dhe shërbimeve për pensionistët, bazuar në rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjes të vitit 2014, të realizuar nga Instituti i Statistikave, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Indeksi i pensioneve dhe trajtimeve të tjera financiare do të bëhet bazuar në ndryshimin mesatar vjetor të çmimeve të grupmallrave e shërbimeve të përcaktuara sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. *Indeksi i ndryshimit mesatar vjetor të çmimeve të grup-mallrave e shërbimeve llogaritet çdo muaj nga Instituti i Statistikave dhe i njoftohet Institutit të Sigurimeve Shoqërore çdo datë 10 të muajit pasardhës.*

4. Në rastet kur ndryshimi i indeksit mesatar vjetor të çmimeve rezulton negativ, shumta e pensioneve individuale në datën e vlerësimit njihet e drejtë e fituar dhe nuk i nënshtrohet një rivlerësimi në ulje. Si e drejtë e fituar, e cila nuk mund të rivlerësohet në ulje, njihet edhe baza e vlerësuar individuale për efekt të llogaritjes fillestare të pensionit, e realizuar deri në vitin e fundit kalendarik, pavarësisht se koeficienti i indeksimit të saj për vitin e fundit kalendarik, i llogaritur sipas përcaktimeve në pikën 3, të nenin 59, “Baza e vlerësuar për llogaritjen e përfitimeve”, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rezulton të jetë më i vogël se “1”.

5. Çdo vit, si pasojë e ndryshimit të indeksit mesatar vjetor të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat janë vlerësuar si bazë për nivelin minimal jetik të pensionistëve, të indeksohen:

a) pensionet, pensionet sociale, shtesat mbi pension dhe të ardhurat e invalidëve nga aksidentet në punë e sëmundjet profesionale, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; nr.4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; dhe nr.7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensionet e caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas nenit 21, të këtij ligji;

c) pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

ç) pensionet e invaliditetit dhe shtesat mbi pension, të caktuara sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993, “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, si dhe shpërblimi i caktuar sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë”;

d) Trajtimet e veçanta, i dhënë nga ligji nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

e) trajtimet e veçanta, të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;

ë) trajtimet e veçanta, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë e nënoficerë, lundruet të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”;

f) trajtimet e veçanta, të caktuara sipas ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”, dhe pensionet familjare, të dhëna sipas ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për

një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”;

g) pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

gj) pensionet suplementare, të caktuara sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

h) pensionet suplementare, të caktuara sipas ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar.

5/1. Në raste të jashtëzakonshme kur ndryshimet në çmimet e konsumit (shporta e konsumit) janë të ndjeshëm (lubatje mujore të mëdha), Këshilli i Ministrave mund të vendosë për indeksimin e përfitimeve nga sigurimet shoqërore më shumë se një herë në vit.

6. Vendimi nr.63, datë 1.2.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për listën e mallrave të zgjedhura për llogaritjen e indeksit dhe përcaktimin e mënyrës e të datës së indeksimit të pensioneve”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Statistikave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

LISTË

GRUPMALLRAT DHE SHËRBIMET E PËRZGJEDHURA PËR LLOGARITJEN E INDEKSIT TË NDRYSHIMIT MESATAR VJETOR TË ÇMIMEVE TË MALLRAVE TË KONSUMIT PËR PENSIONISTËT

Kodi	Grupet e shpenzimeve	Peshat në IÇK
	Gjithsej	100.0
	Ushqime dhe pije joalkoolike	58.8
	Pije alkoolike dhe duhan	1.9
	Veshje dhe këpucë	1.8
	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	12.5
	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	5.7
	Shëndeti	5.5
	Transporti	1.8
	Komunikimi	2.8
	Argëtim dhe kulturë	1.0
	Shërbimi arsimor	0.0
	Hotele, kafene dhe restorante	4.2
	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4.0

Struktura e përmbledhur e grupeve kryesore të mallrave dhe shërbimeve i referohet produkteve të përzgjedhura nga Anketa e Buxhetit të Familjes 2014, e realizuar nga INSTAT-i, të cilat janë bazë edhe për përcaktimin e indeksit të përgjithshëm të ndryshimit mesatar vjetor të çmimeve të konsumit.

Pesha specifike e secilit prej grupmallrave dhe shërbimeve për pensionistët i referohet shpenzimeve mesatare mujore të familjeve me dy pensionistë.

